

Njoftim për pjesëmarrjen në konkurimin publik për qeradhënien e sipërfaqeve (shesh) prej 1 500 m², 2 000 m² dhe 2 000 m² me qëllim depozitimin e mineraleve në portin e Durrësit.

Në zbatim të VKM nr.1712 datë 24.12.2008 "Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore" Autoriteti Portual Durrës, shpall konkurimin për dhënien me qera të objektit "Sipërfaqe 1 500 m², 2 000 m² dhe 2 000 m²" në territorin e Autoritetit Portual Durrës.

Të dhëna për objektin dhe përdorimin.

Përshkrimi i sheshit: Sheshe të destinuara për depozitimin e mineraleve sipas Hartës së Administrimit të territorit të APD.

Vendndodhja: Sheshet e destinuara ndodhen në pjesën lindore të portit, sipas gent planit publikuar në faqen e internetit www.apdurres.com.al

Sipërfaqja: Sipërfaqja e këtyre shesheve është përkatësisht 1 500 m², 2 000 m² dhe 2 000 m².

Afati i qeradhënies: parashikohet të jetë deri në 1 vit.

Veprimtaria që ushtrohet në objekt: Destinacioni i përdorimit të këtyre shesheve është depozitimi i mineraleve .

Mallrat që do të depozitohen nga qeramarrësi në këto sheshe duhet të jenë mallra që janë të destinuara për transport me anije .

Qeramarrësi duhet të përmbushë kërkesat përkatëse të legjislacionit Shqiptar dhe Të Ligjit dhe rregullat për Autoritetin Portual Durrës, si dhe të jetë në përputhje me rregullat dhe ligjet për respektimin e sigurisë (safety and security) dhe mbrojtjen e mjedisit.

Qeramarrësit nuk i lejohet të kryejë apo performojë asnjë *aktivitet përpunimi* përfshirë këtu edhe aktivitetet operacionale. Termi operacion përfshin gjithashtu edhe ngarkimin apo shkarkimin nga mjetet e transportit, trailerat, vagonat e trenave, nga konteinerët ose të njëjstëve të ngjashme (mbushjen apo zbrazjen e tyre).

Qeramarrësi nuk duhet të kryejë asnjë *manipulim* me mallrat në shesh pa marrë më parë aprovimin me shkrim nga APD. Termi *manipulim* përfshin aktivitetet si grumbullimi apo shpërndarja, pastrime, riparime etj.

Çmimi dysheme i qerasë :

Vlera dysheme e qerasë të jetë **2 lekë/m²/ ditë**.

Kriteret e vlerësimit:

Vlera e qerasë 100 pikë

Afati i dorëzimit të ofertave

Ofertat do të dorëzohen në datën **03.02.2011 ora 11.00** në sallën e Mbledhjeve të Autoritetit Portual Durrës.

Ofertat do të hapen më datë **03.02.2011 ora 11.00**, në sallën e Mbledhjeve të Autoritetit Portual në prani të komisionit të shqyrtimit të ofertave dhe subjekteve konkurruese.

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë subjektet konkurruese:

- a) Kërkesa e subjektit për marrjen me qera.
- b) Plan Biznesi për vënien në funksionim të shesheve, ku bëjnë pjesë: Plani i depozitimit të mallrave gjatë kohëzgjatjes së kontratës për një vit, tonazhin, llojet dhe sasi të mallrave që parashikojnë të depozitohen, kontrata paraprake për depozitim.
- c) Ofertën për tarifën mujore të qerasë.
- d) Certifikatën e Regjistrimit të subjektit në QKR.
- e) NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore.
- f) Vërtetimin nga institucionet përkatëse se subjekti nuk është në ndjekje penale dhe se nuk ka proces gjyqësor lidhur me veprimtarinë.
- g) Kontrata të mëparshme lidhur me objektin e veprimtarisë, ku të evidentohet dhe stafi i punësuar në këtë shoqëri.

Për informacione të mëtejshme, Ju lutemi të kontaktoni në Drejtorinë Ekzekutive të Autoritetit Portual, Nr tel/ fax 052 223115 dhe faqen e internetit www.apdurre.com.al